



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/24 ;
Datë: 07.09.2020 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 07.09.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e procedures per hartimin e Planit pesevjecar per zhvillim ekonomik te Komunes se Junikut

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) **Planit pesevjecar per zhvillim ekonomik te Komunes se Junikut**/ në tekstin e mëtejme (projekt) Plani/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Plani, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e hartimit të Planit pesevjecar per zhvillim ekonomik te komunes se Junikut.
- III. Bartëse e hartimit të (projekt) Planit nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e Komunës së Junikut.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Planit është e obliguar që (projekt) Planin ta hartojë në afat prej 4 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Obligohet Kuvendi i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Planit nga pika I. e këtij vendimi.
- VI. (Projekt) Plani duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Planit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit, (projekt) Planit i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Planit sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.